



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 23.7a.9 -2012-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PROCESIN E MENAXHIMIT  
FINANCIAR DHE SISTEMET E KONTROLLIT TË NP INFRAKOS  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2012**

**Prishtinë, Shtator 2013**

---

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për konkluzionin e auditimit mbi sistemet e Menaxhimit financiar dhe kontrollit në NP Infrakos në konsultim me Zv. Auditorin e Përgjithshëm, Artan Venhari i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Konkluzioni dhe raporti i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Myrvete Gashi mbështetur nga Jusuf Kryeziu (Udhëheqës i ekipit), Ganimete Dalloshi dhe Ylber Sadiku.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave.....	4
Përmbledhje e përgjithshme .....	5
Hyrje .....	6
1 Objektiva dhe metodologjia e auditimit .....	8
2 Menaxhimi dhe raportimi në Infrakos .....	9
3 Infrastruktura Hekurudhore në Kosovë dhe Subvencionimi nga Qeveria.....	10
4 Menaxhimi Financiar .....	12
4.1 Performanca e NP Infrakos.....	12
4.2 Menaxhimi i të hyrave .....	12
4.3 Menaxhimi i Prokurimit dhe Blerjeve .....	13
4.4 Kompenzimet.....	14
4.5 Pasuritë.....	16
5 Kontrolli menaxherial.....	19
Shtojca I: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it.....	20

---

## Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
HK	Hekurudhat e Kosovës
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KRPP	Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NP	Ndërmarrje Publike
NJPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
UA	Udhëzim Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

---

## Përmbledhje e përgjithshme

Ky auditim është i fokusuar në sistemin e menaxhimit të NP Infrakos për vitin 2012 duke rishikuar sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit në këtë ndërmarrje. Ne kemi kryer testimet dhe procedurat që menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një konkludim lidhur me këtë proces.

NP Infrakos subvencionohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për të financuar (mbuluar) projektet për investime kapitale, mirëpo edhe përkundër kësaj infrastrukture e Hekurudhave në Kosovë është në gjendje të vështirë dhe paraqet një problem mjaft të madh për vendin tonë.

Synimet e menaxhmentit ishin në menaxhimin e kompanisë drejt rezultateve dhe ngritjes së performancës në përgjithësi mirëpo ne kemi vërejtur disa dobësi në këtë proces. Sistemi i menaxhimit financiar dhe i kontrolleve në përgjithësi nuk është i zhvilluar në mënyrë të duhur për eliminim e dobësive evidente. Kjo do të duhej të adresohet për të përmirësuar performancën e organizatës e cila këtë vitë ka operuar me humbje financiare. Mënyra se si janë menaxhuar të hyrat dhe shpenzimet mund të ketë ndikim në rezultatin financiar të këtij entiteti.

NP Infrakos ka operuar me humbje financiare për shkak të shpenzimeve të përgjithshme të cilat janë më të larta se të hyrat operative. Bordi i drejtorëve duhet të jetë më aktiv për të shqyrtuar të gjitha aktivitetet e kryera nga menaxhmenti krahas rezultateve të arritura.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe i kontrolleve të brendshme, ne ju rekomandojmë që:

- Të siguron kornizën rregullative për të hyrat dhe të krijoni menaxhimin sa më efikas të tyre;
- Të forconi sistemin e kontrollit në njësinë e prokurimit dhe të sigurojni proces më të mirë të blerjeve duke mos anashkaluar procedurat e prokurimit; dhe
- Vendosjen e një sistemi funksional të kontrollit rreth menaxhimit të Resurseve Njerëzore, i cili do të jetë në përputhje me rregullat e brendshme dhe ligjin e punës duke siguruar menaxhim adekuat të personelit.

Menaxhmenti të Infrakosit i është dhënë mundësia për të bërë komente në draftin e këtij raporti. Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditor dhe entitetet e audituara ende kemi pikëpamje të ndryshme, mund ti gjeni në Shtojcën 1. Entitetet e audituara janë zotuar që do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

ZAP shpreh falënderimin për menaxhmentin edhe stafin e përfshirë për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit dhe për ofrimin e të dhënave të nevojshme.

---

## Hyrje

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA (INFRAKOS) ka filluar të veprojë si kompani në Shtator të vitit 2011 si pasuese e Hekurudhave të Kosovës ShA.

Vija e parë hekurudhore në Kosovë u ndërtua në vitin 1874 në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Infrakosi i menaxhon dhe mirëmban 333 km të linjave ekzistuese hekurudhore, 105 kilometra në stacione dhe mbi 100 kilometra linja industriale, sistemet e sinjalizimit, sistemet e komunikimeve, sistemet e energjetikës, 32 stacione hekurudhore, 115 ura me gjatësi prej 2988 metrash, 23 tunele me gjatësi prej 9020 metrash, 759 lëshesa dhe 257 vendkalime në nivel, si dhe ndërtesa tjera dhe pronën tokësore<sup>1</sup>.

Shërbimet të cilat i ofron kjo kompani kanë të bëjnë me:

- Qasja në infrastrukturën hekurudhore që është shërbimi kryesor që ofron kjo kompani dhe aktualisht shërbimet me qasje në rrjet i ofrohen vetem kompanisë Trainkos, ndërsa përveq kësaj ofron edhe
- Shërbimet e ngarkimit dhe shkarkimit të mallrave përmes Terminali të mallrave ;
- Dhënien me qira të tokave, banesave dhe lokaleve afariste përmes sektorit të patundshmërisë; dhe
- Ndërtimin e binarëve industrial.

Shtirirja e rrjetit hekurudhor nëpër Kosovë është i rëndësishëm për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, po ashtu edhe për zhvillimin ekonomik dhe lidhjen e Kosovës me vendet e rajonit.

Rrjeti hekurudhor i Kosovës zgjerohet në një gjatësi prej 333 km (Figura 1) dhe përfshinë linja të paelektrifikuara standarde me linjë njëdrejtimshme.

Linja kryesore lidhet në kurfirin verior, në veri të Mitrovicës në Han të Elezit dhe në kufi me Maqedoninë përmes Fushë Kosovës afër Prishtinës. Kjo linjë ka gjatësi prej 141 km dhe është pjesë e Rjetit hekurudhor qëndror të SEETO-s (Observatori i Transportit i Evropës Juglindore) Rruga 10 që lidhë Shkupin me korridoret VIII dhe X të SEETO-s.

Linjat tjera përfshijnë Fushë Kosovë-Pejë, Klinë-Prizren (Klina gjindet në linjën mes Fushë Kosovës dhe Pejës) dhe Fushë Kosovë-Prishtinë-Podujevë. Disa nga këto linja nuk janë në funksion, sidomos ato që shkojnë në drejtim të kufirit me Serbinë dhe janë në shërbim të qyteteve të rëndësishme si p.sh. Podujevës, dhe linja që ofron shërbimin në Prizren.

---

<sup>1</sup> Të dhënat nga plani i biznesit Infrakos.

Nuk ka lidhje hekurudhore direkte në mes të Kosovës në njerën anë me Mali të zi dhe Shqipërisë në anën tjetër.<sup>2</sup>

Në figurën në vijim do të paraqesim Rrjetin Hekurudhor të Kosovës.

Figura 1 - Rrjeti hekurudhor i Kosovës



Infrakosi është duke u ballafaquar me gjendjen jo të mirë të infrastrukturës dhe pamundësinë për funksionalizimin e plotë të saj. Nga ana tjetër kjo ndërmarrje ka disa përparsi që e veçojnë, ndër kryesoret është se ofron qasje në binar si i vetmi operator në territorin e Kosovës, pastaj mundësia e kycjes në binar industrial në pjesën më të madhe të minierave në Kosovë dhe është linjë lidhëse hekurudhore me vendet fqinje.

<sup>2</sup> Të dhënat lidhur me shtrirjen e rrjetit hekurudhor dhe Linjat e saj janë marr nga Strategjia e transportit multimodal dhe plani i veprimt.

---

# 1 Objektiva dhe metodologjia e auditimit

Objektiva e auditimit është vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në këtë ndërmarrje.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë tona për auditimin e NP Infrakos, ne kemi analizuar dhe ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi intervistuar zyrtarë përgjegjës në Infrakos dhe kemi rishikuar punën për menaxhimin financiar dhe kontroleve të vendosura;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet i përgjigjen kërkesave të brendshme dhe të jashtme të raportimit;
- Kemi rishikuar sistemin e kontrollit të brendshëm, rregulloret, politikat dhe vendimet e nxjerra nga NP Infrakos për të përcaktuar objektivat e vendosura, si dhe aplikimi i tyre gjatë menaxhimit të organizatës;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim; dhe
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare.

---

## 2 Menaxhimi dhe raportimi në Infracos

Ndërmarrja Publike Infracos drejtohet nga Bordi i Drejtorëve i emëruar nga Qeveria e Kosovës dhe menaxhohet nga Kryeshefi Ekzekutiv (KE).

Bordi i drejtorëve ka për detyrë të bëjë mbikëqyrjen rigoroze të punës së zyrtarëve të kompanisë, të drejtoj kompaninë drejt rezultateve pozitive, të sigurojnë se kontrollet financiare dhe sistemi i menaxhimit është i fortë, raportim cilësor financiar dhe detyra tjera të dala nga ligji i Ndërmarrjeve publike.

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të NP Infracos të vendosë sistem funksional të kontrollit të brendshëm dhe të siguroj menaxhim të mirë financiar. NP Infracos duhet të përgatisë pasqyrat dhe raportet financiare në përputhje me ligjin e NP-ve dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimin financiar në bazë të parimit akrual të kontabilitetit.

Kryeshefi Ekzekutiv emërohet nga Bordi i drejtorëve përmes një procedure të hapur, transparente dhe konkurruese. Ai është përgjegjës të menaxhon dhe organizon, vendosjen e kontrolleve adekuate, raportim të rregullt te bordi i drejtorëve si dhe ushtron kompetenca të tjera të rregulluara me ligj.

Menaxhmenti i NP Infracos raporton te Bordi i Drejtorëve, ndërsa Bordi raporton te Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (Ministria e Zhvillimit Ekonomik - MZHE) përmes raporteve tremujore ku pasqyrohen rezultatet financiare për veprimtarinë e kësaj ndërmarrje.

Kjo kompani punon në bazë të kontabilitetit akrual, të hyrat dhe shpenzimet i njeh në momentin e ndodhjes. Po ashtu bazën e të dhënave e ka të dizajnuar në programin Navision ku janë të ndara të gjitha module për çdo kategori.

---

### 3 Infrastruktura Hekurudhore në Kosovë dhe Subvencionimi nga Qeveria

Ndërmarrja Publike Infrakos është ndërmarrje publike qendrore, në pronësi të Qeverisë së Kosovës. Kësaj ndërmarrje përveç shpenzimeve operationale të domosdoshme për funksionim i nevojiten edhe burime financiare për projekte kapitale.

Në bazë të studimit të fizibilitetit i cili është financuar nga Bashkimi Evropian (BE) është hartuar strategjia për transportin multmodal dhe planit të veprimit <sup>3</sup>. Sipas këtij studimi infrastruktura hekurudhore në Kosovë sot është e vjetruar, si dhe nuk është në gjendje të mirë për t'i përmbushur nevojat e udhëtarëve dhe mallrave. Nuk ofron lidhje adekuate me shtetet fqinje dhe portet në ofrimin e shërbimeve të mallrave dhe udhëtarëve dhe ka nevojë për modernizim dhe zhvillim për t'u përballë me nevojat e ardhshme të ofrimit të shërbimeve të qëndrueshme të transportit. Sa i përket strategjisë së financimit lidhur me këtë projekt shqetësimi kryesor është mungesa e fondeve lidhur me investimet dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore për shkak të kostos së lartë. Si alternativa të mundshme për financim të këtij projekti janë paraparë<sup>4</sup>:

- Resurset qeveritare
- Kreditë e jashtme
- Grantet, apo
- Hyrja në Partneritet Publiko Privat (PPP)

Zhvillimi i Rrjetit qendror rajonal ëshë një nga nevoja kyçe për zhvillimin ekonomik dhe social të Evropës Jug-lindore i cili do të fuqizonte lidhjet me vendet fqinje, përshpejtojë rrjedhën e tregut ndërkombëtar dhe do ti ipte një lidhje më të mirë me zonat e largëta rajonale të Evropës Jug-lindore.

- Mirëmbajtja dhe zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore varet nga financimi i Buxhetit të Kosovës. Kjo kompani ka kërkesa të mëdha dhe nuk mund ti realizoj të gjitha projektet investive pa ndihmën e Qeverisë.

Ministria e Zhvillimit ekonomik (MZHE) ka një Marrëveshje për Monitorim dhe Kontroll (MMK) me anë të së cilës transferon subvencione tek NP Infrakos për të mbuluar shpenzimet e saj në kategorinë e subvencioneve dhe investimeve kapitale.

---

<sup>3</sup> Projekt i financuar nga BE i menaxhuar nga Zyra Bashkimit Evropian ne Kosovë.

<sup>4</sup> Të dhënat janë marr nga Strategjia e transportit multimodal dhe plani i veprimit.

---

MZHE gjatë vitit 2012 në bazë të marrëveshjes duhet të transferonte mjetet për investime kapitale për projektet:

- Furnizimi me pjesë rezerve të infrastrukturës në vlerë 935,390€;
- Renovimi i urave dhe tuneleve ne linjat hekurudhore në vlerë 625,697€.

Gjatë vitit 2012 MZHE kishte transferuar në NP Infrakos për investime kapitale vlerën prej 1,521,588€ në përputhje me marrëveshjen që kishte. Nga kjo vlerë 1,561,087€ janë shpenzuar për furnizim me pjesë rezervë dhe renovim të urave dhe tuneleve, ndërsa vlera prej 39,499€ ka mbetur të shpenzohet si projekt në vazhdimësi. Po ashtu kompania kishte raportuar në bazë të obligimeve që i kishte ndaj aksionarit.

### **Konkluzioni i përgjithshëm**

MZHE ka transferuar me kohë subvencionet për ta mirëmbajtur infrastrukturën ekzistuese për kategorit e caktuara në bazë të marrëveshjes që ka tek Infrakosi, po ashtu edhe raportimi i rregullt nga kjo ndërmarrje ndaj aksionarit është kryer në përputhje me marrëveshjen.

---

## 4 Menaxhimi Financiar

### 4.1 Performanca e NP Infrakos

NP Infrakos gjatë vitit 2012 ka realizuar të hyra në vlerë prej 3,163,000€ dhe shpenzime në vlerë 3,215,000€ duke operuar me bilanc negativ dhe krijuar humbje në vlerë prej 52,000€. Kjo humbje ishte dukshem më e vogël se humbja e planifikuar. Të hyrat ishin realizuar për 1,197,000 € më pak krahas planifikimit. Ndërsa shpenzimet ishin më të ulëta për 973,830 € se sa që ishin planifikuar.

Te llogaritë e arkëtueshme vërehet një rritje e madhe gjatë vitit 2012. Nga 788,000€ sa ishin në fund të vitit 2011 ato janë rritur në 1,465,000€. Kemi një rritje të arkëtueshme në vlerë prej 677,000€. Rritja e të arkëtueshmeve në nivel dukshëm më të lartë e rrit rrezikun për krijimin e borgjeve të këqija dhe të dyshimta.

Gjithashtu në llogarit e pagueshme vërehet një rritje në vitin 2012 krahasuar me vitin 2011. Nga 47,730 € sa ishin obligime në vitin 2011 ato janë rritur në 89,000 €.

### 4.2 Menaxhimi i të hyrave

Në NP Infrakos kryesisht gjenerohen të hyra nga shfrytëzimi i rrjetit hekurudhor, te hyra tjera dhe nga grantet. Mënyra se si menaxhohen të hyrat ka ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e kompanisë dhe menaxhimin e parasë publike. Realizimi i të hyrave për vitin 2012 është në vlerë 3,163,191 €, prej të cilave 902,191€ nga grantet dhe pjesa tjetër nga të hyrat vetanake.

Në menaxhimin e të hyrave kjo kompani ballafaqohet me disa çështje që duhet adresuar të cilat do ti shpalosim në vijim.

*Nuk ka "Zyrtar për të hyra"* Në këtë kompani nuk ka zyrtar i cili do të merrej me regjistrimin e të hyrave dhe barazimin e të dhënave me raportet e bankave, në pajtim me LMFPF dhe me rregullën financiare 03/2010. Mungesa e zyrtarit për të hyra mund ketë efekt negativ në menaxhimin e të hyrave vetanake dhe rritë rrezikun që faturimi, arkëtimi dhe njohja e të hyrave mos të bëhet në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe rregullat e tjera.

*Klientët paguajnë qiranë mujore me vonesë ndërsa masa lidhur me këto vonesa nuk janë ndërmarrë* - Për të hyrat nga qiraja klientët nënshkruajnë kontrata me autoritetin kontraktues ku janë të përcaktuara kushtet e pagesës dhe masat ndëshkuese në rast të mospagesës..Kompania ka vonesa lidhur me arkëtimin e të hyrave nga klientët e qiras, në disa raste pagesat nuk ishin bërë me kohë. Në tri mostrat e testuara kemi vërejtur se vonesat në arkëtim kanë ndodhur

---

nga katër (4) deri në njëmbëdhjet (11) muaj, ndërsa sipas kushteve të kontratës afati për pagesë është shtatë (7) ditë nga data e pranimit të faturës edhe përkundër kësaj kompania nuk ka aplikuar ndëshkimet lidhur me këto vonesa.

### 4.3 Menaxhimi i Prokurimit dhe Blerjeve

Procesi i prokurimit është i rregulluar me ligjin e prokurimit publik, i cili është i aplikuar për sektorin publik në Republikën e Kosovës. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen.

Shpenzimet e realizuara të prokurimit për vitin 2012 në Infrakos janë në vlerë 2,539,539€. Kategorisë mallra dhe shërbime i takojnë 197,725.00€ dhe investimeve kapitale 2,341,814.00€.

Në menaxhimin e prokurimit ne kemi vërejtur se kjo kompani ballafaqohet me disa çështje që duhet adresuar të cilat do ti shpalosim në vijim.

Shërbimet e kryera janë zhvilluar pa procedura të prokurimit - kryerja e shërbimeve në këtë mënyrë mund të rezultojnë me ofrimin e çmimeve më të larta nga operatori ekonomikë se që janë çmimet në treg dhe me këtë rast dëmtohet financiarisht autoriteti kontraktues. Ne kemi vërejtur se për dy fatura njëra me vlerë 105€ dhe tjetra 886€ kjo kompani nuk ka zhvilluar fare procedura të prokurimit.

Inicimi i procedurave të prokurimit pa aprovimin e ZKA-së - Aplikimi i kësaj forme pa aprovim të mjeteve nuk është në përputhje me ligjin. Nga mostrat e ekzaminuara në gjashtë prej tyre kemi vërejtur që deklarata e nevojave, disponueshmëria e mjeteve dhe inicimi i aktiviteteve të prokurimit nuk është nënshkruar nga ZKA.

Vonesa në ekzekutimin e pagesave - Moskryerja e pagesave me kohë nga ana e kompanisë përveç se është në kundërshtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike, e njëjta mund të ndikoj në humbjen e imazhit të Kompanisë, si dhe mund të ketë edhe pasoja financiare për shkak të gjobave të cilave mund ti nënshtrohet kompania në rast të mos pagesës po ashtu mund të vije edhe deri tek shpërbërja e njëanshme e kontratës nga operatori ekonomik. Nga mostrat e ekzaminuara në pesë (5) prej tyre është vërejtur se ka pasur vonesa në ekzekutimin e pagesave për më shumë se 30 ditë. Ndërsa sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike faturat për mallrat dhe shërbimet e realizuara duhet të paguhesh brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Planifikimi jo i mirë i prokurimit publik Mos përfshirja e kontratave në planin e prokurimit përveç që nuk është në përputhje me ligjin mund të shpie drejt hyrjes në obligime të pa planifikuara. Sa i përket shërbimeve për mirëmbajtje dhe riparime Infrakos nuk kishte planifikuar vlerën e përgjithshme për këto shërbime. Kjo ka ndodhur për shkak të

---

planifikimit jo të mirë të shpenzimeve vjetore nga departamenti përkatës, dhe një gjë e tillë mund të rezultojë në ndarjen e kërkesave për prokurim të cilat janë kryesisht të njëjta ose të ndërlidhura.

Telefonia fikse dhe mobile Në NP Infrakos për vitin 2012 janë shpenzuar 31,990 €, prej të cilave 19,575€ për telefoninë fikse ndërsa për atë mobile 12,415 €. Gjatë viti 2012 kemi vërejtur që në katër raste zyrtaret e Infrakos kishin tejkalluar limitin e lejuar, mirëpo nuk janë aplikuar ndalesat nga kompania për këto tejkalime. Në vitin 2013 është nxjerr një vendim nga Kryeshefi Ekzekutiv, me anë të së cilit do të aplikohen ndalesat për limitet e tejkaluara.

Sa i përket përdorimit të telefonisë fikse dhe mobile vlen të theksohet:

Regjistrime dhe shpalesje e informatava jo te sakta - Shpenzimet e telefonisë fikse për këtë kompani përmbajnë shpenzimet e telefonisë për dy kompanitë Infrakos dhe Trainkos. Shpenzimet për këtë faturë i paguan Infrakos, mirëpo një pjesë të shpenzimeve të kësaj fature kjo kompani i'a faturon Trainkosit. Te njëjtat nuk janë regjistruar dhe paraqitur si duhet në kontabilitet dhe pasqyra financiare.

Shpenzimet e udhëtimeve të pa dokumentuara Kjo kompania gjatë vitit 2012 kishte shpenzuar për kategorinë e udhëtimeve zyrtare 15,113€. Në tri (3) mostra të ekzaminuara në vlerë prej 2,974.81€ doli që për udhëtimet e zyrtarëve të lartë të NP Infrakos nuk ofrohet ndonjë dëshmi rreth udhëtimit siç është ftesa apo ndonjë formë tjetër në të cilën prezantohet se nga kush do të paguhen shpenzimet e udhëtimit dhe qëllimi i këtyre udhëtimeve. Një gjë e tillë mund të shkakton shpenzime të cilat mund ta dëmtojnë buxhetin e kompanisë, Përveç kësaj në një rast është vërejtur se shpenzimet e udhëtimit ishin të regjistruara në kodin e reprezentacionit duke mos u përfshier si shpenzime për udhëtime zyrtare.

## 4.4 Kompenzimet

Shpenzimet totale për paga dhe mëditje për vitin 2012 ishin 1,691,000 €. Prej tyre 78,669 € kontribute pensionale, dhe 33,508 € i takojnë shpenzimeve tjera për stafin në përgjithësi. Infrakos në gusht të vitit 2012 ka nxjerr dy rregullore: Rregulloren mbi marrëdhënien e punës dhe Rregulloren mbi Pagat dhe Kompensimet, të cilat rregullojnë marrëdhënien e punës, pagesat dhe kompensimet të cilat ju bëhen punëtorëve të Infrakos-it.

Në menaxhimin e personelit kjo kompani ballafaqohet me disa çështje që duhet adresuar të cilat do të shpalesim në vijim.

Rregulloret e brendshme të punës se Infrakos-it nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore - Rregulloret e brendshme të çdo kompanie të cilat rregullojnë marrëdhëniet e punës duhet të jenë në përputhje me Ligjin e punës.

---

Rregullorja e brendshme për mardhënie të punës nuk është në përputhje me ligjin e punës. Së pari në afatin e konkursit publik nuk respektohen në plotësi afatet kohore të përcaktuara në udhëzuesin administrativ (UA nr. 14/2011) dhe së dyti komisioni për marrëdhënie të punës nuk është në përputhje me UA pasi që numri i antarëve të komisionit në këtë rregullore nuk është në përbërje të plotë sa kërkohet me UA.

Rregullorja mbi Pagat dhe Kompensimet Tjera ka paraparë që nëse një punëtor përveç punëve dhe detyrave të veta kryen punët dhe detyrat e punëtorit i cili mungon nga puna, ti bëhet kompensimi i pagës mujore në lartësi prej 20% nga pagesa mujore më e favorshme për punëtorin të cilin e zëvendëson. Mirëpo ky nen i kësaj rregullore nuk ka bazë ligjore në ligjin e punës.

Vlera totale e kompensimeve me 20% që Infrakos ka bërë gjatë vitit 2012 është rreth 6,150.00€. Ndërsa për Kompensimi për komisionin disiplinor dhe të ankesave ka shpenzuar 1,000€.

Mungojnë përshkrimet e vendeve të punës - Punëtorët e kësaj kompanie në kontratën e punës nuk kanë përshkrim të qartë të detyrave të punës. Sipas kontratës punët dhe detyrat janë të përcaktuara në Sistematizimin dhe Përshkrimin e Detyrave të Punës, mirëpo ky dokument nuk është valid sepse i përket periudhës kur ndërmarra ka qenë Hekurudhat e Kosovës SHA. Përshkrimi jo i qartë i pozitës së punës në kontratë, përveq se është në kundërshtim me ligjin e punës, mund të shkaktojë paqartësi lidhur me detyrat dhe përgjegjësit e çdo të punësuarit. Gjatë fazës sa ne ishim në auditim NP Infrakos ishte duke e hartuar këtë rregullore.

Parregullsi gjatë procesit të rekrutimit - Në dy raste të procedurave të rekrutimit për pozitat "Kontabilist saldo balancues" dhe "Zyrtar për shkollim, mbrojtje dhe siguri në punë" kemi vërejtur mangësi në përbërjen e komisionit. Komisioni për zhvillimin e procedurave dhe vlerësimin e kandidatëve është përbërë vetëm nga tre anëtarë i cili sipas UA duhet të përbëhet nga pesë (5) anëtarë, përveq kësaj edhe testi me shkrim nuk është organizuar fare

Zyrtarët e Infrakosit mbajnë pozita ushtrues detyre në kohëzgjatje me të gjatë se që kërkohet me ligj - Menaxheri i Financave mban detyrën e Zyrtarit Kryesor financiar për një vit, ndërsa sipas ligjit kjo pozitë duhet të plotësohet brenda 90 ditëve. Nga stafi i NP Infrakos jemi informuar se kjo pozitë është plotësuar në vitin 2013. Gjithashtu edhe Udhëheqësi i prokurimit që nga Shtatori/2012 mban pozitën ushtrues detyre i menaxherit të prokurimit.

Shpërblehen me kontrata pune pa konkurs publik Në dy raste Infrakos ka pranuar punëtor për punë dhe detyra specifike pa konkurs publik. Konkretisht në pozitat "Asistenti për Planifikim dhe Zhvillim" dhe "Bashkëpunëtor i lartë profesional për qasje në binare". Shkak për këtë shkelje është favorizimi i të punësuarve duke mos iu dhënë mundësi të barabarta për punësim kandidatëve të mundshëm. Kjo ka efekt negativ në konkurrencën e drejte të tregut në burimet njerëzore gjë e cila shpie deri te punësimi i personave jo adekuat.

---

## 4.5 Pasuritë

Totali i pasurive neto të regjistruara në regjistrat e NP Infracos për vitin 2012, duke përfshirë edhe vlerën e pajisjeve nën 1.000€ ishte 19,804,000€.

Në menaxhimin e pasurive kjo kompani ballafaqohet me disa çështje që duhet adresuar të cilat do ti shpalosim në vijim.

*Mungesa e regjistrat të plotë të pasurive* - NP Infracos ka ofruar një regjistër të pasurive mirëpo kjo kompani ende nuk ka arrit të themeloj një regjistër të pasurive me të gjitha informatat e kërkuara me ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe UA për menaxhimin e pasurive.

*Mos formimi i komisionin për vlerësimin e pasurisë* - Kompania ka formuar komisionin për regjistrim të pasurive, mirpo nuk e ka formuar komisionin për vlerësimin e pasurisë i cili do te ishte përgjegjës për vlerësimin e pasurive që nuk kanë vlerë të bartur, vlerësimin e pasurive të dëmtuara dhe vlerësimin e kërkesave për tjetërsim.

*Mungesa e zyrtarit të pasurisë*- NP Infracos nuk e ka të vendosur zyrtarin e pasurisë i cili do të jetë përgjegjës për evidentimin, përcjelljen dhe mirëmbajtjen e regjistrat të përgjithshëm të pasurive me të gjitha informatat e nevojshme.

### **Konkluzioni i përgjithshëm**

Dobësitë e paraqitura më lartë dëshmojnë se NP Infracos nuk ka arritur të vendos një sistem funksional në menaxhimin financiar. Këtë vit kishte operuar me humbje dhe ka rritur shumë llogarit e arkëtueshme si dhe është futur në obligime të reja Për të tejkaluar këtë situatë menaxhmenti i Infracosit do të duhej të përqendrohet më shumë në ngritjen e efikasitetit në veçanti në fushën e menaxhimit të hyrave, prokurimit dhe burimeve njerëzore.

Sfidat të cilat duhet adresuar sa më shpejtë janë mungesa e rregulloreve për të hyrat, harmonizimi i rregulloreve në fushën e burimeve njerëzore dhe progres i ngadalshëm në trajtimin e duhur të aseteve. Me qëllim të menaxhimit sa me të mirë të pasurive qeveritare kompania duhet kushtuar rëndësinë e duhur menaxhimit të pasurive të saj, në mënyrë që ti shmanget humbjes apo keqpërdorimit e tyre.

Bordi i Drejtorëve nuk kanë arritur që plotësisht të bëjnë mbikëqyrjen e duhur të menaxhmentit të kompanisë dhe të eliminojnë parregullsitë e paraqitura.

---

## **Rekomandimet**

### ***Rekomandimi 1 i adresohet Bordit të Drejtorëve që të sigurojë:***

- Analizimin e shkaqeve lidhur me mangësitë e ngritura menaxheriale dhe identifikimin e fushave prioritare me ndikim më të madh buxhetor si dhe të siguroj trajtimin e tyre strategjik duke sjellur rezultate dhe efekte të shpejta.

### ***Rekomandimi 2 ndërlidhet me të dhe hyrat dhe i adresohen Kryeshefit të NP Infrakos që të sigurojë se:***

- Ndarje të duhur të detyrave dhe përgjegjësi brenda organizatës duke siguruar zyrar për të hyrat; dhe
- Respektimin e të gjitha kushteve të kontratave të shitjes.

### ***Rekomandimi 3 ndërlidhet me prokurimet dhe blerjet dhe i adresohen Kryeshefit të NP Infrakos që të sigurojë se:***

- Të gjitha shërbimet të zhvillohen procedura të prokurimit, dhe të gjitha procedurat e prokurimit të bëhen në përputhje me LPP-në, në mënyrë që shpenzimi i parasë të jetë sa më racional.
- Ndërmerren veprime adekuate të cilat sigurojnë funksionimin e procesit nga faza e inicimit e deri te realizimi i prokurimeve.
- Ekzekutimi i faturave realizohet në përputhje me afatet ligjore.
- Planifikimi vjetor i prokurimit bëhet në bazë të nevojave reale të organizatës; dhe
- Të vendosë kontrole adekuate për të monitoruar shfrytëzimin dhe shpenzimet e shërbimeve të telefonisë fikse, mobile dhe udhëtimeve zyrtare, dhe të mbaj regjistra dhe shënime të sakta rreth këtyre shërbimeve.

---

***Rekomandimi 4 ndërlidhet me Burimet Njerzore dhe i adresohen Kryeshefit tëNP Infracos që të sigurojë:***

- Harmonizimin e rregulloreve të brendshme me LMFPP-ne, Ligjin e Punës dhe ligjet tjera ne fuqi, si dhe zbatimin e tyre duke siguruar menaxhim transparent dhe adekuat të personelit;
- Zgjedhjen e çështjes së pozitës së menaxherit të prokurimit.
- Nxjerrjen e një rregullore për përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive për të punësuarit; dhe
- Se përzgjedhja e punëtorëve bëhet sipas ligjit të punës me konkurs të hapur duke ju dhënë mundësinë e barabartë të gjithë të interesuarve.

***Rekomandimi 5 ndërlidhet me Pasuritë dhe i adresohen Kryeshefit tëNP Infracos që të sigurojë:***

- Ndarjen e duhur të detyrave dhe përgjegjësive brenda organizatës, duke e vendosur zyrtarin e pasurisë i cili do të jetë përgjegjës për evidentimin, përcjelljen dhe mirëmbajtjen e regjistrit të përgjithshëm të pasurive me informatat e nevojshme.

---

## 5 Kontrolli menaxherial

Sistemi i mirë i kontrollit të brendshëm e ndihmon çdo organizatë buxhetore në arritjen e objektivave të përcaktuara në shfrytëzimin sa më të mirë të parave publike, duke siguruar raportim të besueshëm financiar.

**Mjedisi i Kontrollit** - Parregullsit e paraqitura në brendi të këtij raportit për komponentën e pagave dhe mëditjeve tregojnë qartë për mjedis të kontrollit të nivelit jo të duhur në NP Infrakos dhe kjo duhet të përmirësohet.

**Vlerësimet e rrezikut** - Pasi që rreziqet lidhen me objektivat, si parakusht i menaxhimit të rrezikut është që objektivat e organizatës të identifikohen në planin Strategjik ose Operativ të saj. Gjatë auditimit që kemi bërë në ndërmarrjen publike qendrore Infrakos SH.A kemi parë se kjo ndërmarrje nuk ka nxjerre një Plan Strategjik në të cilin do të paraqiteshin çështjet, qëllimet dhe objektivat strategjike. Mirëpo NP Infrakos ka përgatitur planin e biznesit në të cilin ka përcaktuar objektivat e sajë për vitin 2012 mirëpo nuk ka identifikuar rreziqet për objektivat e saj.

**Aktivitetet e kontrollit** – NP Infrakos në përgjithësi nuk ka një sistem efikas të kontrollit. Mungojnë kontrolle parandaluese funksionale, të cilat do të ndalojnë ndodhjen e ngjarjeve të pa dëshirueshme.

**Monitorimi** – NP Infrakos nuk ka kryer vlerësime të vazhdueshme dhe vlerësime të veçanta si dhe vlerësime tjera: për të konstatuar nëse kontrollet e brendshme janë të pranishme dhe funksionale.

### Konkluzioni i përgjithshëm

Kontrollet e brendshme të NP Infrakos-it nuk janë të kënaqshme dhe nuk kanë ndonjë siguri për funksionimin e tyre. NP Infrakos në mungesë të funksionimit të plotë të kontrollit të brendshëm nuk ka arritur që të parandalojnë gabimet dhe parregullsitë e mundshme.

#### **Rekomandimi 6**

*Rekomandojmë Kryeshefin e NP Infrakos që:*

- Të ndërmiren masat adekuate për të siguruar që mjedisi i kontrollit të forcohet dhe të eliminohen parregullsitë e paraqitura në këtë komponentë;
- Të sigurojnë se të gjitha transaksionet do të klasifikohen , rexhistrohen dhe të ofrojnë raportim cilësor; dhe
- Të bëhen vlerësime të vazhdueshme në mënyrë që të sigurohen se kontrollet e brendshme funksionojnë në mënyrë të duhur

## Shtojca I: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it

Te gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtimit	Pikepamja e ZAP-it
E gjetura 1: Nuk ka "Zyrtar për të hyra	JO	Që nga ekzistimi i Hekurudhave të Kosovës dhe posaçërisht me futjen në përdorim të softuerit Navision është i përcaktuar punëtori i cili kryen të gjitha të hyrave e kompanisë i cili mbulon pozitën Kontabilistit KLT (të hyrave). Ky zyrtar e përcjell në mënyrë analitike gjendjen e të gjitha të hyrave.	Infrakosi nuk ka zyrtar për të hyra këtë punë e kryen një zyrtar tjetër gjë që nuk është në përputhje me LMFPF dhe rritë rrezikun tek marrja e përgjegjësisë për kryerjen e punëve të caktuara.
E gjetura 2: Shpenzimet e udhëtimeve të pa dokumentuara	JO	Departamenti i financave procedon kërkesa buxhetore për udhëtime zyrtare sipas buxhetit operativ dhe pas përfundimit të udhëtimit zyrtar pranon fatura për arsyetimin e këtyre shpenzimeve të aprovuara sipas nivelit të lejimit. Në disa raste ndodh që udhëtimet të bëhen edhe pa ftesa varësisht nga nevojat e kompanisë dhe nga natyra e vizitës, por që shpenzimet gjithmonë arsyetohen. Ndërsa për regjistrimin e shpenzimit të udhëtimit në kodin e reprezentacionit ka ndodh nga se zyrtarët e Infrakosit kanë shtruar drek pune me KLT.	Komenti i dhënë nga entiteti nuk është relevant për të gjeturën e prezantuar.
E gjetura 3: Rregulloret e brendshme të punës se Infrakos-it nuk	JO	Në përgjithësi rregullorja e marrëdhënies së punës është në pajtueshmëri me LPK nr. 3/L-212. Me UA nr. 14/2011 jemi njoftuar pas nxjerrjes së rregullores dhe do të punojmë në nxjerrjen e rregullores së re e cila në tërësi do të dal e	Komenti i dhënë nga entiteti pohon të gjeturën tonë. Me ligjin LMFPF në nenin 80 theksohet se: Nëse një punonjës, shërbyes civil

<p>janë në përputhje me dispozitat ligjore</p>		<p>përputhur me ligjin e punës.</p> <p>Arsyeshmërinë për futjen e dispozitës mbi pagesën për zëvendësim dhe pagesën e komisionit disiplinor dhe të rasteve të jashtëzakonshme në rregulloren e Infrakosit e kemi bazuar në Nenin 4 LPK i cili thotë “ Akti i brendshëm i punëdhënësit mund të përmbajë dispozita me të cilat përcaktohen më shumë të drejta dhe kushte të favorshme, nga të drejtat dhe kushtet e përcaktuara me këtë ligj</p>	<p>ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, sipas një akti të Qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik, ky punonjës, shërbyes civil ose zyrtar nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur.</p>
<p>E gjetura 4: Mungojnë përshkrimet e vendeve të punës -</p>		<p>Përshkrimet e vendeve dhe detyrave për secilën pozitë janë të grumbulluara në një akt normativ të hekurudhës: Sistematizimi dhe përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës. Ky akt normativ ka ekzistuar edhe para ndarjes së hekurudhave (me të jemi shërbyer deri në vitin 2013 kur jemi duke përgatitur Sistematizimin e ri).</p> <p>Të gjithë punëtorët e rekrutuar në vitin 2012 në shtojcë të kontratave të tyre të punës kanë të bashkangjitur aneksin “Përshkrimi i detyrave të punës” si ekstrakt nga sistematizimi dhe përshkrimi i detyrave të punës i aplikuar para ndarjes së hekurudhave. Në vitin 2013 është filluar me formën e kontratës së punës të cilën e ka dhënë MPMS-ja.</p>	<p>Fakti qëndron që nuk janë këto përshkrime dhe entiteti duhet të finalizojë sistematizimin për Infrakos me përshkrimin e vendeve të punës (të cilën edhe vet entiteti e pohon në koment).</p>